

**I. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall vende pune për personel akademik pranë Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës si më poshtë:**

**A. 2 (dy) vende pune për personel akademik të kategorisë asistent-lektorë në Departamentin e Arkitekturës në lëndët “Workshop 1, 2, 3”, në Programin e studimit Bachelor në Arkitekturë Interieri e Dizajn, si dhe në lëndët “Gjeometri Deskriptive dhe Vizatim Teknik”, në Programin e studimit MSHA (Profili Arkitekt, Profili Urbanist), si dhe në programe Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi, Hidro, Mjedisi e Gjeodezi;**

**Kandidatët për personel akademik në kategorinë “Asistent-lektorë” pranë Departamentit të Arkitekturës në Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës, duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:**

1. Të zotërojnë Diplomë të ciklit të dytë në Arkitekturë ose Dizajn;
2. Kandidatët për personel akademik me kohë të plotë duhet të ketë një mesatare të përgjithshme të ponderuar të studimeve të larta të të dy cikleve apo të ciklit të integruar, **jo më pak se 80/100** (statuti i UPT-së, neni 42 pika b);
3. Të kenë të paktën 3 vite eksperiencë profesionale dhe akademike;
4. Të zotërojnë të paktën një nga gjuhët: anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht, spanjisht.

## **II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi ku të përfshijë:
  - *Pozicionin e kërkuar*
  - *Arsyet e kandidimit*
  - *Çfarë i ofron kandidati institucionit / departamentit / grup-lëndëve*
  - *Përmbledhje mbi qasjen teorike / metodologjike të kandidatit për lëndët ku do të angazhohet. (500 fjalë)*
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MAS);
5. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
6. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
9. Dëshminë e gjuhës së huaj të noterizuar.
10. *Portfolio* punësh të lidhura me disiplinat e vendit vakant.
11. Letër reference nga punëdhënësi i fundit
12. Letër reference nga 2 persona me gradë ose titull akademik (referenca të paraqitet në zarf të mbyllur të firmosur nga referenti).

**Nëse ka, kandidati mund të paraqesë edhe:**

1. Deri në dy publikime të plota të përzgjedhura (artikull, ese, punime shkencore etj.)
2. Dokumentin e fitimit të gradës shkencore “Doktor”
3. Dokumente të tjera të lidhura me aplikimin.

**B. 1 (një) vend pune për personel akademik të kategorisë “Lektor” në Departamentin e Urbanistikës, në lëndët:**

- *Urbanistikë 1 (seminare);*
- *LZ: Teori bashkëkohore të urbanizimit.*

**Kandidatët për personel akademik në kategorinë “Lektorë” pranë Departamentit të Urbanistikës në Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës, duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:**

1. Të zotërojnë Diplomë të nivelit Bachelor dhe Master i Shkencave ose Master i Integruar Shkencor në Arkitekturë dhe Urbanistikë;
2. Të zotërojnë gradën shkencore “Doktor” në Arkitekturë dhe Urbanistikë;
3. Kandidatët për personel akademik me kohë të plotë duhet të ketë një mesatare të përgjithshme të ponderuar të studimeve të larta të të dy cikleve apo të ciklit të integruar, **së paku 80/100** (statuti i UPT-së, neni 42 pika b);

4. Të kenë të paktën 5 vite eksperiencë profesionale dhe/ose akademike;
5. Preferohet notë mesatare mbi 9 për lëndët që mbulon Departamenti i Urbanistikës;
6. Preferohet të kenë eksperiencë mësimdhënie në lëndët e specifikuara;
7. Preferohet të kenë botuar artikuj shkencor në fushat që mbulon departamenti;
8. Të zotërojnë të paktën një nga gjuhët: anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht, spanjisht.

## **II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

13. Letër motivimi ku të përfshijë;
14. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
15. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
16. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MASR);
17. Dokumentin e fitimit të gradës shkencore “Doktor”;
18. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
19. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
20. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
21. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
22. Dëshminë e gjuhës së huaj të noterizuar.
23. *Portfolio* punësh të lidhura me fushën e arkitekturës dhe urbanistikës;
24. Letër reference nga 2 persona me gradë ose titull akademik (referenca të paraqitet në zarf të mbyllur të firmosur nga referenti).

### **Nëse ka, kandidati mund të paraqesë edhe:**

4. Deri në dy publikime të plota të përzgjedhura (artikull, ese, punime shkencore etj.)
5. Dokumente të tjera të lidhura me aplikimin.

**Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës 22.09.2023 pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratit e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.**